

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit Islam Thaçi, me sekretaren juridike Rafete Syla, në lëndën penale kundër të pandehurit A. R. , për shkak të veprës penale, shpërdorim i pasurisë së huaj nga neni 330 paragrafi 5 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.236/2016, të datës 08.02.2016, të cilën e përfaqësonte Prokurorja e Shtetit Huma Jetishi, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar dhe publik, më 10.11.2016 , mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri A. R. nga babai I. dhe nëna S., e lindur H., i lindur më ... në P., me vendbanim në fsh. B. K.Gj., ka të kryer shkollën ..., ... punësuar, ... martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar shtetas i R.Kosovës, i pa dënuar si dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale kundër tij,

ë s h t ë f a j t o r

S e p s e me datë2016, rreth ores ... minuta, në Gj., në rr. ,,...., në parkingun e marketit ,,...., me qëllim të vetes ti sjell dobi pasurore të kundërligjshme, ka përvetësuar pasurinë e luajtshme-portofolin e të dëmtuarit N. A. nga fsh.L. i ulët i Komunës së Gj., të cilin ky e kishte gjet e në të cilën kishte 115 €, 2 kartela të bankës, 1 kartel të sigurimit, letërnjoftimin dhe patentshoferin, në atë mënyrë që duke hy në veturën e tij e gjenë-vërenë portofolin e përmendur në tokë, e merr atë dhe nga i njëjti i merr paratë kurse portofolin në fjalë e futë cedilën e parë kah ana e pasagjerit dhe nuk e raporton në polici por e fsheh dhe në këtë mënyrë e dëmton të dëmtuarin për këtë portofol dhe sendet e përmendura, të

cilat më pas gjat kontrollit iu nxunë prej Policisë, iu sekuestruan dhe të njëjtat iu dorëzuan të dëmtuarit,

me çka ka kryer veprën penale shpërdorim i pasurisë së huaj nga neni 330 paragrafi 5 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4,41,49,50,51,52 ,73 , 74 , 75 dhe 76 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurit , i shqipton

Dënim me kusht

Ashtu që të pandehurit A. R., i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve dhe dënim me gjobw nw shumw prej 150 (njëqindpesëdhjetë) €, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i pandehuri, brenda afatit prej 1 (një) viti, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht, ka për t'iu revokuar.

I pandehuri detyrohet që në emër të paushallit gjyqësor të arkëtojë shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Temelore në Gjilan, pranë kësaj gjykate, ka paraqitur aktakuzë kundër të pandehurit, A. R. për veprën penale, shërdorim i pasurisë së huaj nga neni 330 paragrafi 5 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën për shqyrtim gjyqësor në të cilën kanë prezentuar Prokurorja e Shtetit Huma Jetishi dhe i pandehuri A. R..

Pas leximit të aktakuzës nga PSH ,i pandehuri A. R., e ka kuptuar aktakuzën, përkatësisht veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata e ka njoftuar të pandehurin me të drejtat e tijë në kuptim të nenit 246 të KPPRK-së, pas këtij njoftimi, i pandehuri e ka pranuar fajësinë, për veprën penale shërdorim i pasurisë së huaj nga neni 330 paragrafi 5 të KPRK-së, në pajtim me përshkrimin faktik si në dispozitiv të aktakuzës,

Prokurorja e shtetit Huma Jetishi në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar: pasi që në shqyrtimin e sotëm fillestar i pandehuri A. R. e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale shpërdorim i pasurisë së huaj nga neni 330 paragrafi 5 të KPRK-së, i cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije të plotë pasi që nga ana e gjykatës u njoftua lidhur me pasojat dhe favore të pranim të fajësisë, andaj në tërsi mbetem pranë këtij akti akuzues dhe të gjitha propozimeve që i përmban e njejtë ashtu që i propozoj gjykatës që të pandehurin e lartëcekur t'a shpallë fajtor dhe ta dënoj me dënim meritore sipas ligjit. Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata të marrë parasysh si rrethanat lehtësuese ashtu edhe ato rënduese.

I pandehuri A. R. në fjalën e vet përfundimtare ka deklaruar: e ndiej vetën fajtor për kryerjen e kësaj veprë, pendohem për të njëjtën, i kërkoj falje të dëmtuarit, por e njoftoj gjykatën se unë nuk kam pasur për qëllim që portofolin e gjetur që mos t'ia kthej të dëmtuarit dhe se ditën kritike nuk kam mundur menjëherë që atë portofol ta lajmëroj në Polici. Në fundë kërkoj nga gjykata që brenda mundësive të më shqiproj një dënim sa më të butë.

Gjyqtari ka vlerësuar se i pandehuri, e ka pranuar fajësinë dhe se pranimi është bërë pasi që i njejtë e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranim të fajit, pranimi i fajit nga i pandehuri është bërë vullnetarisht, i mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza si dhe në materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit.

Aktakuza poashtu nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, prandaj në këtë çështje penale gjendja faktike nuk ka qenë kontestuese, andaj gjykata ka gjetur se i pandehuri A. R. në vendin dhe kohën e përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, ka kryer veprën penale, shpërdorim i pasurisë së huaj nga neni 330 paragrafi 5 të KPRK-së.

Andaj të pandehurin në fjalë e shpalli fajtorë dhe i shqiptoj dënimin me kusht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit për të akuzuarin, gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikim që dënimi të jetë më i butë apo më i rëndë, ashtu siq e parasheh edhe dispozita e nenit 73 dhe 75 të KPRK-së.

Gjykata në rastin konkret ka gjetur rrethana veçanërisht lehtësuese të cilat mundësojnë shqiptimin e dënimit të kushtëzuar, përmes të cilit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 dhe 50 të KPRK-së. Si rrethanë lehtësuese për të pandehurin, gjykata pati parasysh faktin se i njejtë e ka pranuar fajsinë për veprën penale të kryer, wshtw penduar pwr tw njejtwn si dhe faktin se i njejtë i ka kwrkuar falje tw dwmturit.

Ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin, gjykata pati parasysh,shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore tw veprws.

Me dënimin e shqiptuar për të pandehurin , gjykata vlerëson se do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që të pandehurin do ta parandalojë që në të ardhmen të mos kryejë vepra tjera penale dhe se ky dënim do të ndikojë edhe tek qytetarët tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale

Për shpenzimet e procedures gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 parag. 1, e në lidhje me nenin 450 parag.1 nën parag. 2 .6 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,
Departamenti i pergjithshëm.
Më dt .10.11.2016

Sekretarja juridike,
Rafete Syla,d.v.

Gj y q t a r i
Islam Thaçi,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.